



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Pas disa raporteve në media lidhur me përkthimin e aktgjyimit në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala* dhe disponueshmërinë e aktgjyimit për publikun, dëshirojmë të qartësojmë se një version jopërfundimtar i përkthimit në shqipe të aktgjyimit të plotë u dorëzua më 4 shtator dhe është në dispozicion të z. Shala dhe mbrojtësit të tij që nga ajo ditë. Zyra Administrative ka njoftuar gjykatën se versioni përfundimtar i përkthimit, i rishikuar nga redaktorët, pritet të dorëzohet nga fundi i tetorit 2024.

Versioni publik i aktgjyimit në anglishte u lëshua më 24 shtator, me redaktimet që nevojiten për të mbrojtur identitetin e dëshmitarëve dhe viktimave. Versionin e redaktuar publik të aktgjyimit mund ta gjeni në faqen e internetit të DHSK-së.

Duke pasur parasysh kriterin për të siguruar që dokumentet të përkthehen me standardet më të larta, përkthimi i tyre kërkon njëfarë kohe të finalizohet në çështjet gjyqësore ku gjuha e punës është anglishtja. Sidoqoftë, DHSK-ja u kushton prioritetin më të lartë përkthimeve të aktgjyimeve dhe dokumenteve të tjera që duhet t'i jepen çdo të pandehuri në gjuhën e tij.

Seanca gjyqësore u mbajtën gjatë gjithë kësaj jave në gjykimi e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Gjatë konferencës për ecurinë e çështjes të mbajtur të martën për të diskutuar afatet dhe planifikimin e gjyimit, Kryegjykatësi informoi se deri të premten, 27 shtator, kishin dhënë dëshmi gjithsej 159 dëshmitarë në çështjen gjyqësore, në mënyra të ndryshme të dhënies së dëshmisë, përfshirë dëshmitë në sallë të gjyqit, dëshmitë me shkrim dhe kombinim i të dyjave.

88 nga këta 159 dëshmitarë kanë dhënë dëshmi në sallë të gjyqit, ku përfshihen dëshmitarët dëshmia e të cilëve u pranua dëshmia me shkrim dhe të cilët u paraqitën në sallë të gjyqit për t'u marrë në pyetje nga pala jothirrëse. 71 dëshmi të tjera u pranuan vetëm me shkrim, në bazë të rregullave 153 dhe 155.

Sa u takon dëshmitarëve të mbetur që do të thirren nga Prokuroria, Kryegjykatësi theksoi se Trupi Gjykues ishte informuar nga ZPS-ja se ajo planifikon të thërrasë edhe 65 dëshmitarë të tjerë për të dhënë dëshmi në sallë të gjyqit si dhe që synon të kërkojë pranimin në prova edhe të 54 dëshmitarëve të tjera me shkrim të dëshmitarëve.





Duke pasur parasysh se prilli 2025 është afati i synuar që Prokuroria të përfundojë paraqitjen e provave të saj, u diskutuan edhe hapat e mundshëm për përshpejtimin e gjykimit. Konkretisht, Kryegjykatësi pyeti Prokurorinë nëse planifikon dhe si planifikon t'i përmbahet afatit të synuar të prillit 2025. Prokuroria tha se synon të zvogëlojë numrin e dëshmitarëve që do të japin dëshmi në sallë të gjyqit dhe të thërrasë më pak dëshmitarë se që u dha në vlerësimin aktual.

Gjatë kësaj jave, në gjykim dëshmuuan katër dëshmitarë. Të hënën paradite, një dëshmitar dha dëshmi me masa mbrojtëse, kryesisht në seancë private. Sipas përmbledhjes që lexoi Prokuroria në sallë të gjyqit, dëshmitari është civil shqiptar nga Kosova që u mbajt i ndaluar në 1998 në një bazë të UÇK-së dhe u keqtrajtua.

Pas dëshmisë së këtij dëshmitari të mbrojtur, Prokuroria thirri Ahmet Rrahmanajn, i cili ishte anëtar i njësitit "Lumi" të policisë ushtarake të UÇK-së gjatë periudhës që lidhet me akuzat. Dëshmia e tij, e cila ishte publike, përfundoi të hënën pasdite.

Të mërkurën, dha dëshmi Stamena Jelliq nëpërmjet videolidhjes. Sipas përmbledhjes që lexoi Prokuroria, anëtarë të UÇK-së morën bashkëshortin e dëshmitares, Marko Jelliq, nga shtëpia e tyre në Rahovec në gusht 1999, dhe ai është i zhdukur që nga ajo kohë. Dëshmia e dëshmitares u dha kryesisht në seancë publike.

Dëshmitari i katërt për këtë javë filloi dhënien e dëshmisë sot paradite. Ky është dëshmitari i 95-të i thirrur nga Prokuroria për të dëshmuar në sallë të gjyqit. Dëshmitari po dëshmon në seancë plotësisht të mbyllur.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 2 tetor, Trupi Gjyqës miratoi kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave lidhur me ndryshimin e masave mbrojtëse për një viktimë pjesëmarrëse në proces.

Konferencat përgatitore për gjykim në çështjen e Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës janë caktuar për javën e ardhshme më 7, 8 dhe 9 tetor, nga ora 09:30 deri 16:00, sipas nevojës. 10 dhe 11 tetori janë caktuar si data rezervë për seancat. Data e propozuar për fillimin e gjykimit është 11 nëntori 2024.

Më 30 shtator, Administratorja informoi Trupin Gjyqës lidhur me miratimin me kusht të znj. Marion Karin (Marion Carrin) si bashkëmbrojtëse e Ismet Bahtijarit.

